



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 25

Prishtinë, më 4.2. 2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Fadil Demaku, nënkryetar i parë, Bojan Mitiq, nënkryetar i dytë, Anton Quni, Qerim Bajrami, dhe Nuredin Ibishi, anëtarë.

Munguan: Daut Haradinaj, Rexhep Selimi, Ganimete Musliu dhe Zafir Berisha.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarife Aliu.

Pjesëmarrës të tjerë: Blend Zyrapi-KIPRED; Dhurata Kryeziu-OSBE; Bardha Xhoi-KIPRED dhe Mërgime Kajtazi-KDI.

Mbledhjen e kryesoi, Fadil Demaku, nënkryetar i parë i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura më 20.11.2015 dhe 22.12.2015;
3. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2016;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi i Komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të datës 4.11.2015

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2016

Kryesuesi- Theksoi që është draftuar plani i punës për vitin 2016 dhe se në të janë të përfshira projektligjet që do të shqyrtohen gjatë këtij viti. Takimi i sotëm do të jetë për t'u njoftuar me të dhe një takim tjetër për të bërë finalizimin e tij. Po ashtu, njoftoi që lidhur me planin e punës, është ofruar mbështetja nga OSBE-ja për organizimin e një punëtorie, ku do të diskutojmë për planin e punës. Më tutje, fjalën ua dha anëtarëve të Komisionit.

Nuredin Ibishi- Theksoi se e vlerëson draftin e planit të punës dhe shtoi se është pranuar edhe Strategjia Kombëtare për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ku janë një sërë detyrash të përcaktuara në të dhe janë në kapitullin e 31 të Acquis, që i referohet politikës së jashtme, sigurisë dhe mbrojtjes. Po ashtu, theksoi se ligjet që duhet të ndryshohen dhe plotësohen janë paraparë në Strategjinë Legjislative për vitin 2016, por që nga Strategjia për zbatimin e MSA-së, dalin edhe një sërë veprimesh të tjera, që duhet të ndërmerren.

Po ashtu, theksoi se është paraparë edhe Ligji për Kuvendin dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit, legjislacionin kornizë, që ka të bëjë me zbatimin e dispozitave për sundimin e ligjit, si dhe amendamentet kushtetuese që kanë të bëjnë me transformimin e FSK-së dhe misionin e Forcave të Armatosura dhe Projektligji për komisionarin e Forcave të Armatosura. Po ashtu, theksoi se është i nevojshëm rishikimi edhe një herë i draftit të punës, për të planifikuar më mirë dhe mbikëqyrja e zbatimit të rekomandimeve të Ligjit për Policinë e Kosovës dhe të Ligjit të IPK-së. Po ashtu, vizitat studimore të planifikohen se cilat shtete do të vizitohen, pra që janë më të avancuar dhe të marrim praktikat më të mira.

Anton Quni- Sa i përket draftit të planit të punës, tha se nuk ka vërejtje dhe nuk do të ndalet në specifikat. Më tutje, theksoi se plani është paraparë për një situatë të rëndomtë, pavarësisht që nuk është shpallur situatë e jashtëzakonshme, por besoj që pajtohemi që nuk jemi në një situatë të rëndomtë, prandaj edhe plani i punës duhet të jetë në raport me situatën e cila është krijuar. Pasi është fakt, që janë tendencat për paralizimin e punës së Kuvendit dhe protestat e dhunshme të cilat kanë ndodhur. Kjo situatë e vë Policinë e Kosovës në situata të tilla, që me gjithë kapacitetet që ka, të menaxhojë turmat, me ç'rast zhvendoset vëmendja nga luftimi i veprimeve kërcënuese ndaj jetës dhe pasurisë së qytetarëve, por edhe ndaj Republikës së Kosovës, me gjithë atributet e saj.

Në situata të tilla, krijohen parakushte që motivojnë elementet dhe formacione të ndryshme kriminale, radikale me motive të ndryshme, siç janë, materiale ideologjike nacionale, që mund të kërcënojnë stabilitetin politiko-ekonomik të Kosovës dhe se në këtë kohë, bashkëpunimi dhe komunikimi i Komisionit me institucionet e sigurisë, duhet të jetë me intensitet shumë më të

lartë. Pasi që zhvillimet në rajon dhe kërcënimet janë në rritje dhe të natyrës që mund të parandalohen vetëm me kapacitetet e policisë, por janë përgjegjësi ushtarake, çështja e shndërrimit të FSK-së në Forca të Armatosura Ushtarake, duhet të trajtohet me një prioritet të lartë, nga të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces, si ata vendorë, ashtu edhe ata ndërkombëtarë, të nivelit politik dhe profesional. Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha këto, plani i punës duhet të jetë i natyrës së tillë, i diktuar nga rrethanat, zhvillimet e reja dhe kërkesat e kohës.

Kryesuesi- Pajtohet plotësisht me çështjen e shtruar nga z. Quni, por që realiteti është ky që është dhe çështjet e sigurisë lidhen dhe janë punë e Komisionit, por që ne kemi dy çështje, me të cilat përballemi: është reflektimi i gjendjes politike të opozitës në sigurinë e vendit, që kërkon një trajtim të veçantë dhe nuk di sa do të arrijmë ta bëjmë pjesë të planit të punës së Komisionit, ndërsa çështja e dytë është më e lehtë, pasi që pasi i kemi kornizat e bëra gati, ndërsa sa i përket situatës së parë, janë çështje që nuk varen nga Komisioni, por edhe nga faktorë të tjerë relevantë.

Bojan Mitiq- Fillimisht, uroi për fillimin e punës në Komision për vitin 2016. Po ashtu, theksoi se viti i kaluar ka qenë i vështirë, sidomos për pjesëtarët e komuniteteve të tjera, duke shpresuar që duke punuar të gjithë së bashku, të tejkalohet kjo situatë e vështirë. Ndërsa, sa i përket planit të punës, tha se e ka analizuar dhe se për këtë vit janë planifikuar shumë projektligje, dhe si anëtar i këtij Komisioni, do të japë kontributin e tij. Sa i përket Projektligjit për transformimin FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës, tha se do të bisedojë me kolegët, që përfaqësojnë Listën Serbe dhe se do të dilet me deklaratë se çfarë qëndrimi do të mbajnë. Ndërsa, sa i përket planit të punës, tha se e përkrah fillimin e punës, sipas tij.

Qerim Bajrami- Duke uruar për fillimin e punës për këtë vit, kërkoi që edhe deputetët nga opozita të kthehen në Kuvend, në mënyrë që të vazhdohet normalisht puna në Komision dhe se kjo është për të mirën e Kosovës. Sa i përket planit të punës, vlerësoi se duket plan i ngarkuar dhe se duhet angazhim i madh për ta realizuar. Lidhur me planifikimin e vizitave në terren, propozoi që mesatarisht të jetë një vizitë në çdo muaj, pasi aktualisht numri i deputetëve në Komision është më i vogël.

Kryesuesi- Theksoi që në takimin e radhës do të përcaktohet më qartë, nëse plani i punës është i ngarkuar ose jo.

Anton Quni- Duke u ndërlidhur me qëndrimin e z. Bojan Mitiq, në gatishmërinë e tij për të biseduar me kolegët deputetë të komunitetit serb, inkurajoi që të llobojë për krijimin e Ushtrisë së Kosovës, si forcë shumetnike, me standarde perëndimore, për krijimin e një force që do të jetë në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Rreziqet që i kërcënohen Kosovës, janë rreziqe që i përfshijnë të gjithë qytetarët, prandaj do të ishte mirë që z. Mitiq të lobonte dhe të takohej me ata që mund të jenë skeptik për formimin e Ushtrisë së Kosovës.

Kryesuesi- Sa i përket përfundimit të planit të punës për vitin 2016, propozoi që të caktohet data e mbajtjes së punëtorisë në mbështetje të OSBE-së.

Dhurata Kryeziu- Propozoi që punëtorja për planin e punës së Komisionit për vitin 2016, të mbahet në “Vila Gërmia”-Prishtinë, më 11 ose 12 shkurt, ku do të ftohen edhe përfaqësuesit e organizatave vendore dhe ndërkombëtare, që e përkrahin punën e Komisionit, në mënyrë që të përfshihen aktivitetet e planifikuara nga OSBE-ja, si dhe organizatat tjera.

Kryesuesi- Duke marrë pëlqimin edhe të anëtarëve të Komisionit, të mbetet që dita e enjte, 11 shkurt, dhe nëse ka ndryshime eventuale për këtë agjendë, do të njoftoheni me kohë.

4. Të ndryshme

Kryesuesi- Në këtë pikë propozoi që në mbledhjen e radhës së Komisionit, të ftohet komandanti i Përgjithshëm i FSK-së, për të raportuar në Komision.

Bojan Mitiq- Theksoi se pajtohet me këtë propozim dhe se është një obligim ligjor që të raportojë në Komision komandanti i FSK-së, marrë në konsideratë edhe situatën në terren.

Qerim Bajrami- Theksoi që në prezantimin e mëparshëm që është bërë nga ana e komandantit të FSK-së, është ngritur nga ana e tij një çështje për komunitetin boshnjak, lidhur me pjesëtarët e këtij komuniteti në FSK. Theksoi se prapë do të kërkojë sqarime për këtë çështje në takimin e radhës kur do të raportojë komandanti i FSK-së, pasi ka vërejtje nga terreni për këtë çështje dhe kërkoi përkrahjen e Komisionit.

Nuredin Ibishi- Vlerësoi qëndrimin e z. Bojan Mitiq, që të llojë për çështjen e transformimit të FSK-së. Më tutje, theksoi se pajtohet me qëndrimin e z. Quni, që çështja e sigurisë ka marrë përmasa shqetësuese dhe formimi i forcave që është i paraparë edhe me Pakon e Ahtisarit, dhe më vonë, edhe në Kushtetutë dhe në legjislacion, duke vazhduar tutje integrimin në struktura siç është NATO dhe që formimi i forcës të jetë shumetnike, si dhe të jetë një qasje e përbashkët e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

Gjithashtu, theksoi se sa i përket çështjes së zbatimit të Ligjit të prokurimit, në kuadër të FSK-së, kjo çështje është ngritur edhe në media, dhe për këtë qëllim, propozoi që komandantit të FSK-së, t’i dërgohet një kërkesë, që të specifikojë lidhur me blerjen e 24 automjeteve, nëse eventualisht mund të ketë shkelje të rregullave të prokurimit.

Më tutje, vlerësoi se Komisioni është vonuar në punën e tij, pasi si Komision, duke vlerësuar situatën e caktuar, të organizojmë takime. Po ashtu, theksoi se sa i përket Konferencës “Gërmia Hill”, nuk janë të ftuar si anëtarë të Komisionit, marrë në konsideratë që janë diskutuar çështje të sigurisë dhe kjo është shqetësuese për mua.

Qerim Bajrami- Theksoi se përveç tij, i ftuar në këtë konferencë ka qenë edhe z. Ismet Beqiri.

Kryesuesi- Shtoi që kjo çështje duhet të verifikohet, nëse në e-maillet zyrtare është dërguar ftesa për këtë konferencë dhe më pas mund të diskutojmë për këtë çështje.

Qerim Bajrami- Ngriti shqetësimin e humbjes së jetës së një qytetari nga komuniteti boshnjak në Fushë- Kosovë, më 21 janar 2016 dhe se deri më tani nuk ka asnjë rezultat për zbardhjen e këtij rasti. Për këtë arsye, kërkoi që si Komision, nëse kemi mundësi, të kërkojmë sqarime nga ana e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës.

Kryesuesi- Lidhur me çështjen e ngritur nga z. Bajrami, tha se si Komision, mund të kërkojmë sqarime nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë, kur ta kemi të ftuar në Komision. Po ashtu, inkurajoi që, duke qenë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, mund t'u drejtohet instancave më të larta të shtetit për këtë çështje. Ndërsa, sa i përket çështjes se mund të kemi situata të veçanta dhe nevoja për të thirrur mbledhje të Komisionit, theksoi që në bazë të Rregullores së Kuvendit, mund të thërrasim mbledhje të tilla.

Me këtë pikë të rendit të ditës, mbledhjen e konsideroi të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Nënkryetari i parë i Komisionit,

Fadil Demaku